



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 01, Datë 13.01.2022

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMARRJES SË ERE-S PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË “AGE KUÇ” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KUÇ” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1930
KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative si dhe neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15 të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 164/8 prot, datë 11.01.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s për licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 239, datë 26.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30 vjeçar.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 49 prot., datë 10.01.2022, ka paraqitur dokumentacion në lidhje me mungesat e konstatuara në këtë aplikim dhe për këtë arsye ERE-s i nevojitet koha e mjaftueshme për të shqyrtuar këtë dokumentacion apo për të zhvilluar senacë dëgjimore me shoqërinë nëse do të vlerësohet e nevojshme. Në të tilla rrethana, vleresojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s.

- Lidhur me shtyrjen e vendimmarrjes , në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

3. “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor”.

- Po ashtu, “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, në nenin 14 pika 3, të saj përcakton se:

3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç” me kapacitet të instaluar 1930 kW.
2. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI